



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE

SEKTORI JURIDIK



Nr. 177/1 prot.

Tiranë, më 22/02/2020.

URDHËR

Nr. 22, Datë, 24/02/2020

MBI

DISA MASA PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 39 (Rektori), nenin 131, të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikë ne Shqipërisë", Urdhrit nr. 8, datë 14.01.2020, të MASR, "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me VSA nr. 19. 02.2020,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, në datën **09/04/2020**;
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, është data **08/05/2020**;
3. Senati Akademik, **brenda datës 06/03/2020**, zgjedh me votim të fshehtë, anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), me përfaqësues nga çdo fakultet dhe studentët. Senati cakton edhe sekretarin e KIZ, i cili është anëtar patë drejtë vote pranë KIZ. Dekanët e fakulteteve, brenda afateve të përcaktuara, të organizojnë punën në zbatim të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", për të sensibilizuar personelin akademik.
4. Në zbatim të nenit 11 (Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", DMBNJ pranë rektoratit të UART në bashkëpunim me departamentet pranë fakulteteve, të hartojnë listat e zgjedhjeve për personelin akademik, të punësuar më kohë të plotë, **brenda datës 07/04/2020**;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr 2, 1019, Tiranë, Shqipëri | tel +355 42 225 488 | www.uart.edu.al

URDHËR
Nr. 22, date 24/02/2020



